



Pranuar / Dorezuar Puniljeno/Predato Received/Delivered	06.01.2022	2	viti god year
Organ /Rjeshta Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMBACH	25/2022		1/1



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.953/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, me Avdyll Bekteshin-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.953/2020 të datës 23.11.2020 të parashtruar nga ankuesi i përfaqësuar me autorizim nga Avokat me adresë:
Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit numër:11/44 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.01.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër Nr.11/44 i datës 10.11.2021 dhe çështja kthehet në RYSHQYRTIM dhe rivendosje tek Qeveria e Republikës së Kosovës.
- II. OBLIGOHET Kryeministri i Republikës së Kosovës që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, bazuar në shkresat e lëndës me datë 21.09.2020 është emëruar Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë së Kosovës me Vendimin Nr.16/31 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës me mandat katër (4) vjeçar.

Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 10.11.2021 ka nxjerr Vendimin numër Nr.11/44, përmes të cilit e ka shfuqizuar Vendimin Nr.16/31 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 21.09.2020, me ç'rast ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës-respektivisht ushtrimi i mandatit të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.



I pakënaqur me Vendimin Nr.11/44 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 10.11.2021, ankuesi me datë 23.11.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e cila është protokolluar me numër: 5593/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 02.02.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në aneksë te Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa me datën 01.12.2021 nëpërmjet e-mailit e ka njoftuar Zëvendësuesin e Sekretarit të Zyrës së Kryeministrit për parashtrimin e ankesës nga ankuesi. Këshilli me datë 28.12.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme/DMZP, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 23.11.2021 me numër protokollit 5593/2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Shkresën me përmbajtjen e portalit qeveritar për konkursin e datës 25.06.2020 me konkursin e bashkangjitur për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës; Vendimin me numër Ref: VVMP 1555/20 i Gjykatës Kushtetuese ndërlidhur me rastin nr.KO203/19 për vazhdimin e masës së përkohshme i datës 27.04.2021; Vendimin Nr.16/31 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 21.09.2020; Vendimin numër Nr.11/44 të Qeverisë së Republikës së Kosovës i datës 10.11.2021, Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Autorizimin e përfaqësuesit-avokatit i datës 17.11.2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 02.12.2021; Përgjigjen në kërkesë e datës 28.12.2021; E-mailin e datës 01.12.2021 dërguar nga Këshilli për A.K; E-mailin e datës 22.12.2021 dërguar nga Sh.L për A.K me korrespondencën e bashkangjitur; Kërkesën për iniciimin e procedurës së rekrutimit e datës 19.06.2020 me numër:931; Kopjen e shpalljes së konkursit në gazetën Epoka e Re të datës 25.06.2020; Lista e kandidatëve pjesëmarrës në konkurs; Vendimin e Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme me numër:763/2020 i datës 24.07.2021; Listën e ngushtë përfundimtare të datës 05.08.2020; Përmbledhjen e vlerësimeve individuale Form.MAP-SHCK-09 e datës 25.08.2020; Raporti i Komisionit për Vlerësimin e Kritereve i datës 25.08.2020; Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër Nr.08/138 e datës 22.03.2017; Dëshminë për pranimin e aplikacionit e datës 06.07.2020; Kërkesën për punësim të ankuesit e datës 06.07.2020; Letër rekomandimin e datës 03.07.2020; Pasqyrën e llogarisë së trustit për ankuesin; Çertifikatën e datës 30.06.2020 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë-Dega Klinë; CV-në e ankuesit; Diplomën e datës 09.07.1988 me numër:6689; letër motivimi të datës 04.07.2020.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda e ankuesit të kthehet në **rishqyrtim dhe rivendosje** duke e obliguar Qeverinë e Republikës së Kosovës që të bëjë rishqyrtimin e Vendimit numër Nr.11/44 të datës 10.11.2021 përmes të cilit ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, **sepse**:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, se Qeveria e Republikës së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër Nr.11/44 të datës 10.11.2021 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative pasi që vendimi si i tillë nuk i plotëson kriteret e parapara formale të akti administrativ, mungon arsytimi, këshilla juridike dhe në vetvete është kundërthënës dhe i paligjshëm, po ashtu me pretendimin se vendimi në fjalë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 10.11.2021 ka nxjerr Vendimin numër Nr.11/44, përmes të cilit e ka shfuqizuar Vendimin Nr.16/31 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 21.09.2020, me ç'rast ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës-respektivisht ushtrimi i mandatit të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës me arsytimin si në pikën II të diapozitivit të vendimit në fjalë, citoj: "*Marrë parasysh që procesi*



i rekrutimit dhe emërimi i z.

është bërë në pajtim me legjislacionin e shfuqizuar për Shërbimin

Civil, në kohën kur në fuqi ishte Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili shprehimisht ndalon një veprim të atillë, emërimi aktual në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Këshillin e Sigurisë duhet zëvendësuar me emërim të përkohshëm”, mirëpo Kolegji vlerëson se Qeveria e Republikës së Kosovës nuk ka arritur të arsyetojë vendimin siç përcaktohet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: “Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave si dhe 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret”, ngase Qeveria e Republikës së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër Nr.11/44 të datës 10.11.2021 nuk ka arritur të arsyetojë Vendimin në fjalë se pse në rastin konkret kanë qenë të zbatueshme dispozitat ligjore të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përderisa Gjykata Kushtetuese me datë 27.04.2020 ka nxjerrë vendimin për vazhdimin e masës pezulluese për Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa i njëjti sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO203/1 të datës 09.07.2020 ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë, ndërlidhur me këtë me rastin e hyrjes në Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik me datë 09.07.2020 në dispozitat transitorë ka rregulluar edhe procedurat e rekrutimit të cilat janë shpallë para hyrjes në fuqi referuar Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe po ashtu Qeverisë së Republikës së Kosovës me rastin e nxjerrjes së vendimit të ankimuar nuk ka arritur ta sqarojë mjaftueshëm situatën faktike mbi bazën e së cilës është marrë vendimi, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se mungesa e arsyetimit të mjaftueshëm të Vendimit numër Nr.11/44 nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës është e barabartë me mungesën e tij siç përcaktohet me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 48 paragrafi 2 i cili përcakton se: “Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”.

Po ashtu, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka gjetur se Vendimi numër Nr.11/44 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datë 10.11.2021 nuk përmban edhe këshillën juridike e cila është pjesë e elementeve të detyrueshme të aktit administrativ siç përcaktohet qartë në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative: “*pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike)*”, ndërlidhur me këtë asnjë rrethanë nuk ka ekzistuar që vendimi i ankimuar të mos përmbajë arsyetim të mjaftueshëm, përveç në rastet kur e përcakton Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 49 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3: “*1.1. përjashtohet shprehimisht me ligj; 1.2. akti administrativ i nxjerrë, sipas kërkesës, miraton në tërësi kërkesën e palës kërkuese dhe nuk i cënon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale të tjetër, ose 1.3. akti administrativ i nxjerrë, sipas detyrës zyrtare, nuk cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale*”, ngase në rastin konkret vendimi në fjalë ka prodhuar efekte juridike për palën në momentin e hyrjes në fuqi referuar nenit 51 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcakton se: “*Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cënohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij*”, dhe si i tillë ka cënuar të drejtat e ankuesit që burojnë nga marrëdhënia e punës, ndërsa nuk është udhëzuar në mjete juridike, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se Vendimi numër Nr.11/44 i Qeverisë së Republikës së Kosovës i datë 10.11.2021 për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurave administrative është i kundërligjshëm siç e përcakton Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3: “*Një akt administrativ është i paligjshëm nëse është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative*”, dhe ekziston bazë e mjaftueshme që lënda e ankuesit respektivisht nxjerrja e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të kthehet në rishqyrtim.

Kolegji duke u bazuar në parimin e Kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, ka konstatuar se është obligim i Qeverisë së Republikës së Kosovës që të bëjë arsyetimin e vendimeve kur një gjë e tillë kërkohet nga ligji siç është rasti me Ligjin Nr. 05/L-031.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.953/2021

Avdyll BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

[Signature]
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit-Avokatit
- Kryeministrit të Republikës së Kosovës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit ;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme
- Arkivit të KPMSHCK-së